

UDHËZIM

Nr.3, datë 19.1.2009

PËR RASTET E SHITJES, TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË LICENCUARA TË LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10/5 të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", Ministri i Financave

UDHËZON:

Shoqëritë e licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit, përpara se të transferojnë, shesin, të lënë peng dhe çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, duhet të njoftojnë paraprakisht NJMLF-në.

I. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit duhet të paraqesin panë NJMLF-së për shitjen e aksioneve të tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Njoftim për shitjen e aksioneve të shoqërisë transferimin apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre.
2. Dokumentin që shoqëria nuk është në proces likuidimi apo falimentimi.
3. Vendimin e organeve të shoqërisë që miratojnë shitjen, transferimin apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, sipas dispozitave që ka në statut.
4. Vërtetim nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime ndaj shtetit.

II. Subjektet që do të blejnë aksionet e shoqërive të licencuara në fushën e lojërave të fatit të paraqesin pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Vendimin e regjistrimit në gjykatë si person juridik me objekt veprimtarie në fushën e lojërave të fatit, aktin e themelimit dhe statusin e shoqërisë.
2. Deklaratat e burimit të kapitalit, shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën lojërave të fatit.

III. Shoqëritë e licencuara për ushtrim veprimtarie për kazino dhe lotari kombëtare, për shitjen e aksioneve, transferimit, lënies peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, të paraqesin në NJMLF këto dokumente:

1. Njoftim për shitjen e aksioneve të shoqërisë, transferimin, lënien peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre.
2. Vendimin e organeve të shoqërisë që miratojnë shitjen, transferimin, lënien peng apo çdo formë tjetër të zotërimit të aksioneve të tyre, sipas dispozitave që ka në statut.
3. Vërtetim nga organet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi, që shoqëria nuk ka detyrime ndaj shteti.

IV. Subjekti që do të blejë aksionet e shoqërisë në veprimtari kazino apo lotari kombëtare, duhet të paraqesë në NJMLF këto dokumente:

1. Dokumentet origjinale apo të noterizuara, që vërtetojnë se ai është i organizuar në formë shoqërisë apo grupime shoqërisë, me objekt veprimtarie në fushën e kazinove apo lotarive kombëtare, si dhe aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.
2. Dokumente që shoqëria nuk është në proces likuidimi, falimentimi a ndonjë proces të ngjashëm në vendin ku kanë selinë qendrore, apo në vende të tjera ku ushtron veprimtarinë.

3. Një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove apo lotarisë kombëtare, nëse ka, të dhënë nga organi përkatës i vendit ku ato kanë selinë qendrore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni i shtetit ku kanë selinë qendrore apo të vendeve të tjera ku ushtrojnë veprimtarinë në fushën e kazinove apo lotarisë kombëtare.
 4. Deklarata për burimin e kapitalit dhe të shumave të tjera që do të investohen për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e kazinove në vendin tonë, madhësinë e kapitalit të paktën në të njëjtën nivel me shoqërinë, e cila ka fituar të drejtën e lejes për veprimtari kazinoje apo lojtari kombëtare.
 5. Vërtetim nga organet përkatëse për detyrimet e natyrës fiskale apo të natyrave të ngjashme kundrejt shtetit e tyre apo shteteve të tjera ku ato ushtrojnë veprimtarinë si për shoqërinë, edhe për çdo subjekt në rast grupimi.
 6. Dhënia ose marrja me qira e lojërave elektronike me fitim në çast nuk lejohet.
- Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode